



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1568/ 6 prot.

Datë 16/07/2025

V E N D I M

Nr. 917/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16/07/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “NIKA” SHPK me NIPT J76705047U dhe me adresë: Lagjja “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skenderbeu” Godinë 8-katëshe, Kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587” 4001, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.05.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II.2. Në datë 27.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në datën 03.06.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"KOMBEAS" SHPK BOE "PROGRES SHKODRA	23,815,491.00	leke	kualifikuar
2	SHPK & BEAN SHPK"	23,839,573.00	leke	skualifikuar
3	"NIKA" SHPK	24,389,237.13	leke	skualifikuar
4	"NDERTUESI 2000" SHPK	24,800,684.50	leke	skualifikuar
5	"CARA" SHPK	25,182,097.35	leke	kualifikuar
6	"S.M.O.UNION" SHPK	25,198,870.18	leke	kualifikuar
7	"OUEN" SHPK	26,291,653.62	leke	kualifikuar
8	"NDERTIMI" SHPK	26,470,116.00	leke	kualifikuar
9	"NDERTUESI 2014" SHPK	27,299,494.00	leke	kualifikuar
10	"XHASt" SHPK "KEVIN KONSTRUKSION"	27,873,623.10	leke	skualifikuar
11	SHPK "O.B.KONSTRUKSION"	27,950,223.89	leke	kualifikuar
12	SHPK	28,800,000.00	leke	skualifikuar
13	"T & XH" SHPK BOE "EIDON-GRUP SHPK &	28,821,469.79	leke	kualifikuar
14	JUNIKSHPK"	30,636,140.00	leke	skualifikuar
15	"DESARET COMPANY" SHPK	31,950,910.19	leke	kualifikuar
16	"SENKA" SHPK "AK GREEN	0.00	leke	skualifikuar
17	KONSTRUKSION" SHPK	0.00	leke	skualifikuar

II.4. Në datën 03.06.2025, operatori ekonomik "NIKA" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin, si më poshtë vijon:

"II. O.E "NIKA shpk me NUIS J76705047U" shpk, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme: OE me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.3 të "Kapacitetit teknik" të kriterëve të veçanta për kualifikim e cila përcakton:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: a) Kontratë pune e vlefshme;
b) Diplomë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për plotësimin e kësaj kërkesë OE Nika shpk ka paraqitur deklaratë dt. 27.05.2025 në të cilën përcakton: Shkoder, me 27/05/2025

DEKLARATE

Une e nenshkruara Shpresa Nika, me cilesinë administratorit të operatorit ekonomik "NIKA" sh.p.k. deklaroj se ne rast se do të jemi fitues ne tenderin që do të zhvillohet në datë dt. 27/05/2025; nga Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara; me objekt: "Rikonstruksioni i objektit nr.2, "godinë 3-katëshe", në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër", dhe me numër reference: REF-47417-05-09-2025, drejtues teknik i angazhuar per kete tender do te jete znj. Gentiana Mosko:

1. Drejtues teknik Gentiana Mosko:

2. E cila figuron e punesuar ne shoqerine "NIKA" Sh.p.k , dhe ka qene e angazhuar ne dy kontrata te tjera por eshte zevendesuar dhe njoftuar autoriteti kontrator (investitori) konform neneve 2 e 4, Kreu I te Udhezimit nr. 2, date 13.5.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit". Ajo do te jete e pranishem/disponueshem gjate te gjithë kohes qe do te kryhen punimet per objektin e mesiperm. (Bashkangjitur kesaj deklarata do te gjendet dhe shkresat percjellese per zvendesimin e drejtuesit teknik).

Shkresat bashkëlidhur janë:

1. Shkresë nr.19 prot, datë 21.02.2025 "Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri" drejtuar AK MEKI në të cilën përcakton se në objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec, me REF-30787-11- 25-2024 me vlerë objekti 52,933,902.3 lekë pa TVSH në të cilën është caktuar drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko, nga ana e shoqërisë NIKA shpk për arsye objective kemi ndryshuar Drejtuesin Teknik duke caktuar z. Hektor Kusaku, ing. Ndërtimi i pajisur me licensën nr.1976/2, dt.04.07.2003 si Përgjegjës Teknik Kantieri

2. Shkresë nr.20 prot, datë 21.02.2025 "Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri" drejtuar AK MEKI në të cilën përcakton se në objektin "Rikonstruksion I shkollës së mesme profesionale "Arben Broci" Shkodër, me REF-31115-11-26- 2024 me vlerë objekti 167,518,221.60 lekë pa TVSH në të cilën është caktuar drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko, nga ana e shoqërisë NIKA shpk për arsye objective kemi ndryshuar Drejtuesin Teknik duke caktuar z. Adrian Kalamishi, ing. Ndërtimi i pajisur me licensën nr.1207/5, dt.31.10.2006 si Përgjegjës Teknik Kantieri.

Nga verifikimi i objekteve të mësipërme dhe dokumentacioni përkatës i ngarkuar në SPE nga ky operator për këto 2 objekte konstatohet se:

1. Në objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec, me REF-30787-11-25-2024 me vlerë objekti 52,933,902.3 lekë pa TVSH

a). OE ka deklaruar Drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko me arsyetimin: "E cili figuron e punesuar ne shoqerine "NIKA" Sh.p.k, dhe eshte deklaruar drejtuese teknike tek objekti: "Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (Prona 240, Godina nr. 34), Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, Rikostruksion i objektit 2 katësh në Kepin e Palit.", objekt per te cilin shoqeria "NIKA" sh.p.k eshte ne pritje te lidhjes se kontrates (ku pergjegjes kantieri do te jete Adrian Kalamishi, inxhinier ndertimi, sipas Udhezimit Nr. 2 date 13/05/2005 te Keshillit te Ministrave (Per zbatimin e punimeve te ndertimit, Pika 2.1, [ku Drejtuesi teknik per objekt me vlere nen 30.000.000 tridhjetë milion leke nuk duhet te jete rezident ne kantier, por duhet te caktoje pergjegjesin e kantierit]). Gjithashtu dhe sipas

vendimit Nr. 731, date 29/07/2022 paragrafi III.6.4.2 i KPP-se, drejtues teknik tek objekti qe prokurohet: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec” me nr reference: REF-30787-11-25-2024 do te jete e lartpermendura, Znj.Gentiana Moska.

b). Vlera fituese e këtij objekti është 44,111,585.2 [dyzet e kater milion e njeqind e njembedhjetë mijë e peseqind e tetedhjetë e pese pike dy]

2. Në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër me REF-31115-11-26-2024 me vlerë objekti 167,518,221.60 lekë pa TVSH

a). OE ka deklaruar Drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko me arsyetimin: “E cila figuron e punesuar ne shoqerine “NIKA” Sh.p.k , dhe eshte deklaruar drejtuese teknike tek objekti: “Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (Prona 240, Godina nr. 34), Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, Rikostruksion i objektit 2 katësh në Kepin e Palit.”, objekt per te cilin shoqeria “NIKA” sh.p.k eshte ne pritje te lidhjes se kontrates (ku pergjegjes kantieri do te jete Adrian Kalamishi, inxhinier ndertimi, sipas Udhezimit Nr. 2 date 13/05/2005 te Keshillit te Ministrave (Per zbatimin e punimeve te ndertimit, Pika 2.1, [ku Drejtuesi teknik per objekt me vlere nen 30.000.000 tridhjetë milion leke nuk duhet te jete rezident ne kantier, por duhet te caktoje pergjegjesin e kantierit]). Gjithashtu dhe sipas vendimit Nr. 731, date 29/07/2022 paragrafi III.6.4.2 i KPP-se, drejtues teknike tek objekti qe prokurohet: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec” me nr reference: REF-30787-11- 25-2024 do te jete e lartpermendura, Znj.Gentiana Moska.

b). Vlera fituese e këtij objekti është 139,598,518 [njëqind e tridhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë] lekë pa tvsh.

3. Për të dy objektet e mësipërmë kontrata është nënshkruar përkatësisht në datat:

- “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec, me REF-30787-11-25-2024 më datë 12.02.2025,
- “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër me REF-31115-11-26-2024 më datë 04.02.2025.

Në analizë të sa më sipër rezulton se OE NIKA SHPK ka fituar kontratat e mësipërme duke plotësuar kërkesën për kualifikim e cila kërkon “Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave” duke deklaruar znj gentiana Mosko e cila plotësin kushtet e mësipërme pasi në momentin e shpalles fitues inxhinierja nuk ka qenë e angazhuar në kontrata të tjera.

Në rastin konkret, deklarimet e OE NIKA shpk:

Së pari paraqesin konfuzion pasi ky operator nga dokumentacioni i sipërcituar deklaroi ing. Adrian Kalamishi në dy objekte:

1. Në objektin: “Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (Prona 240, Godina nr. 34), Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, Rikostruksion i objektit 2 katësh në Kepin e Palit dhe në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër.

2. Ky inxhinier nuk mund të jëtë prezent në kantier në të dy objektet njëkohësisht në shkelje të neneve 2 e 4, Kreu I te Udhezimit nr. 2, date 13.5.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”. Bazuar në vlerën e objekteve, duke qenë se vlera e rikonstruksionit të shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër është 139,598,518 lekë pa TVSH, pra mbi 3,000,000 lekë, Drejtuesi Teknik znj. Gentiana Mosko duhet të jëtë rezidente në kantier dhe nuk mund të caktoj pergjegjes kantieri.

3. Gjithashtu konstatohet se inxhinierët e propozuar për ndryshim, z. Adrian Kalamishi dhe z. Hektor Kusaku, nuk rezultojnë të jenë të përfshirë në licencën e zbatimit të shoqërisë “Nika” shpk, kusht ky me të cilin OE është shpallur fitues për të dy objektet e sipërcituar.

Së dyti deklarimet e OE Nika shpk se zëvendësimet e inxhinieres znj. Mosko është bazuar në neneve 2 e 4, Kreu I të Udhezimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” nuk qëndron, pasi bien në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik përkatësisht:

A. Ligj 169/2020 I ndryshuar pika 1 e Nenit 124 i cili përcakton:

Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës

1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

B. VKM 285/2021 e ndryshuar pika 1;2 dhe 6 e nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” i cili përcakton: 1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuar me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë, ose që lidhen me punësimin. Këto kushte nuk duhet të rëndojnë ose të favorizojnë operatorin ekonomik fitues, ato duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. 6. Komisioni i ngritur nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi është struktura përgjegjëse për ndjekjen me përpikëri të ecurisë së zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokuruar dhe me legjislacionin në fuqi.

Referuar legjislacionit të mësipërm OE nuk mund të ndryshojë drejtuesin Teknik të caktuar në dokumentat e ofertës të paraqitura në SPE, pasi kjo është në shkelje të legjislacionit të sipërcituar dhe kushteve të kontratës.

Në konkluzion të analizës së mësipërme rezulton se Drejtuesi teknik i caktuar për këtë objekt nga OE NIKA shpk znj. Gentiana Mosko është e angazhuar në dy kontrata të sipërcituara dhe OE nuk plotëson kriterin 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 12.06.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “OUEN” SHPK.

II.6. Në datën 18.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5431, datë 18.06.2025 dhe me nr. 1568/2025 prot, datë 18.06.2025 e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1568/1, datë 19.06.2025, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datë 27.06.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 1435/6 prot, datë 25.06.2025 “*Vendim KSHA 52/2025*”, protokolluar me tonën me nr. 1568/2 prot, datë 27.06.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Me shkresën nr. 1435/7 prot, datë 26.06.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me tonën me nr. 1568/3 prot, datë 27.06.2025, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, së bashku me shkresën nr. 1435/6 prot, datë 25.06.2025 “*Vendim KSHA 52/2025*”, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik ankimues “NIKA” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “*II. O.E “NIKA shpk me NUIS J76705047U” shpk, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme: OE me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim e cila përcakton:*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se

nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: a) Kontratë pune e vlefshme;

b) Diplomë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për plotësimin e kësaj kërkesë OE Nika shpk ka paraqitur deklaratë dt. 27.05.2025 në të cilën përcakton: Shkoder, me 27/05/2025

DEKLARATE

Une e nenshkruara Shpresa Nika, me cilesinë administratorit të operatorit ekonomik "NIKA" sh.p.k. deklaroj se ne rast se do të jemi fitues ne tenderin që do të zhvillohet në datë dt. 27/05/2025; nga Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara; me objekt: "Rikonstruksioni i objektit nr.2, "godinë 3-katëshe", në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër", dhe me numër reference: REF-47417-05-09-2025, drejtues teknik i angazhuar për kete tender do te jete znj. Gentiana Mosko:

1. Drejtues teknik Gentiana Mosko:

2. E cila figuron e punësuar në shoqërinë "NIKA" Sh.p.k, dhe ka qene e angazhuar në dy kontrata të tjera por është zëvendësuar dhe njoftuar autoriteti kontraktor (investitori) konform neneve 2 e 4, Kreu I të Udhezimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndertimit". Ajo do të jetë e pranishme/disponueshme gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punimet për objektin e mesiperm. (Bashkangjitur kësaj deklarata do të gjendet dhe shkresat përcjellese për zëvendësimin e drejtuesit teknik).

Shkresat bashkëlidhur janë:

1. Shkresë nr.19 prot, datë 21.02.2025 "Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri" drejtuar AK MEKI në të cilën përcakton se në objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec, me REF-30787-11- 25-2024 me vlerë objekti 52,933,902.3 lekë pa TVSH në të cilën është caktuar drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko, nga ana e shoqërisë NIKA shpk për arsye objektive kemi ndryshuar Drejtuesin Teknik duke caktuar z. Hektor Kusaku, ing. Ndërtimi i pajisur me licensën nr.1976/2, dt.04.07.2003 si Përgjegjës Teknik Kantieri

2. Shkresë nr.20 prot, datë 21.02.2025 "Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri" drejtuar AK MEKI në të cilën përcakton se në objektin "Rikonstruksion I shkollës së mesme profesionale "Arben Broci" Shkodër, me REF-31115-11-26- 2024 me vlerë objekti 167,518,221.60 lekë pa TVSH në të cilën është caktuar drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko, nga ana e shoqërisë NIKA shpk për arsye objektive kemi ndryshuar Drejtuesin Teknik duke caktuar z. Adrian Kalamishi, ing. Ndërtimi i pajisur me licensën nr.1207/5, dt.31.10.2006 si Përgjegjës Teknik Kantieri.

Nga verifikimi i objekteve të mësipërme dhe dokumentacioni përkatës i ngarkuar në SPE nga ky operator për këto 2 objekte konstatohet se:

1. Në objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec, me REF-30787-11-25-2024 me vlerë objekti 52,933,902.3 lekë pa TVSH

a). OE ka deklaruar Drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko me arsyetimin: “E cili figuron e punesuar ne shoqerine “NIKA” Sh.p.k, dhe eshte deklaruar drejtuese teknike tek objekti: “Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (Prona 240, Godina nr. 34), Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, Rikonstruksion i objektit 2 katësh në Kepin e Palit.”, objekt per te cilin shoqeria “NIKA” sh.p.k eshte ne pritje te lidhjes se kontrates (ku pergjegjes kantieri do te jete Adrian Kalamishi, inxhinier ndertimi, sipas Udhezimit Nr. 2 date 13/05/2005 te Keshillit te Ministrave (Per zbatimin e punimeve te ndertimit, Pika 2.1, [ku Drejtuesi teknik per objekt me vlere nen 30.000.000 tridhjetë milion leke nuk duhet te jete rezident ne kantier, por duhet te caktojë pergjegjesin e kantierit]). Gjithashtu dhe sipas vendimit Nr. 731, date 29/07/2022 paragrafi III.6.4.2 i KPP-se, drejtues teknike tek objekti qe prokurohet: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec” me nr reference: REF-30787-11-25-2024 do te jete e lartpermendura, Znj.Gentiana Moska.

b). Vlera fituese e këtij objekti është 44,111,585.2 [dyzet e kater milion e njeqind e njembedhjetë mijë e peseqind e tetedhjetë e pese pike dy]

2. Në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër me REF-31115-11-26-2024 me vlerë objekti 167,518,221.60 lekë pa TVSH

a). OE ka deklaruar Drejtues Teknik znj. Gentiana Mosko me arsyetimin: “E cila figuron e punesuar ne shoqerine “NIKA” Sh.p.k , dhe eshte deklaruar drejtuese teknike tek objekti: “Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (Prona 240, Godina nr. 34), Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, Rikonstruksion i objektit 2 katësh në Kepin e Palit.”, objekt per te cilin shoqeria “NIKA” sh.p.k eshte ne pritje te lidhjes se kontrates (ku pergjegjes kantieri do te jete Adrian Kalamishi, inxhinier ndertimi, sipas Udhezimit Nr. 2 date 13/05/2005 te Keshillit te Ministrave (Per zbatimin e punimeve te ndertimit, Pika 2.1, [ku Drejtuesi teknik per objekt me vlere nen 30.000.000 tridhjetë milion leke nuk duhet te jete rezident ne kantier, por duhet te caktojë pergjegjesin e kantierit]). Gjithashtu dhe sipas vendimit Nr. 731, date 29/07/2022 paragrafi III.6.4.2 i KPP-se, drejtues teknike tek objekti qe prokurohet: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec” me nr reference: REF-30787-11- 25-2024 do te jete e lartpermendura, Znj.Gentiana Moska.

b). Vlera fituese e këtij objekti është 139,598,518 [njëqind e tridhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë] lekë pa tvsh.

3. Për të dy objektet e mësipërmë kontrata është nënshkruar përkatësisht në datat:

- “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec, me REF-30787-11-25-2024 më datë 12.02.2025,
- “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër me REF-31115-11-26-2024 më datë 04.02.2025.

Në analizë të sa më sipër rezulton se OE NIKA SHPK ka fituar kontratat e mësipërme duke plotësuar kërkesën për kualifikim e cila kërkon “Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave” duke deklaruar znj gentiana Mosko e cila plotësin kushtet e mësipërme pasi në momentin e shpalles fitues inxhinierja nuk ka qenë e angazhuar në kontrata të tjera.

Në rastin konkret, deklarimet e OE NIKA shpk:

Së pari paraqesin konfuzion pasi ky operator nga dokumentacioni i sipërcituar deklaroi ing. Adrian Kalamishi në dy objekte:

1. Në objektin: “Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (Prona 240, Godina nr. 34), Rikonstruksion i pjesshëm i godinës, Rikonstruksion i objektit 2 katësh në Kepin e Palit dhe në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër.

2. Ky inxhinier nuk mund të jëtë prezent në kantier në të dy objektet njëkohësisht në shkelje të neneve 2 e 4, Kreu I të Udhezimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Bazuar në vlerën e objekteve, duke qenë se vlera e rikonstruksionit të shkollës së mesme profesionale “Arben Broci” Shkodër është 139,598,518 lekë pa TVSH, pra mbi 3,000,000 lekë, Drejtuesi Teknik znj. Gentiana Mosko duhet të jëtë rezidente në kantier dhe nuk mund të caktoj përgjegjës kantieri.

3. Gjithashtu konstatojmë se inxhinierët e propozuar për ndryshim, z. Adrian Kalamishi dhe z. Hektor Kusaku, nuk rezultojnë të jenë të përfshirë në licencën e zbatimit të shoqërisë “Nika” shpk, kusht ky me të cilin OE është shpallur fitues për të dy objektet e sipërcituar.

Së dyti deklarimet e OE Nika shpk se zëvendësimet e inxhinieres znj. Mosko është bazuar në neneve 2 e 4, Kreu I të Udhezimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit” nuk qëndron, pasi bien në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik përkatësisht:

A. Ligj 169/2020 I ndryshuar pika 1 e Nenit 124 i cili përcakton:

Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës

1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

B. VKM 285/2021 e ndryshuar pika 1;2 dhe 6 e nenit 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës” i cili përcakton: 1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuar me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë, ose që lidhen me punësimin. Këto kushte nuk duhet të rëndojnë ose të favorizojnë operatorin ekonomik fitues, ato duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës. 6. Komisioni i ngritur nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi është struktura përgjegjëse për ndjekjen me përpikëri të ecurisë së zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokuruar dhe me legjislacionin në fuqi.

Referuar legjislacionit të mësipërm OE nuk mund të ndryshojë drejtuesin Teknik të caktuar në dokumentat e ofertës të paraqitura në SPE, pasi kjo është në shkelje të legjislacionit të sipërcituar dhe kushteve të kontratës.

Në konkluzion të analizës së mësipërme rezulton se Drejtuesi teknik i caktuar për këtë objekt nga OE NIKA shpk znj. Gentiana Mosko është e angazhuar në dy kontrata të sipërcituara dhe OE nuk plotëson kriterin 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.3.2 dhe pika 2.3.3. “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË

KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e veçantë kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP-3B Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- NS-1A Punime për prishjen e ndërtimeve.

- NS-2A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.

- NS-4B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

- NS-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

- NS-14 A Impiante te brendshme elektrike , telefonike ,radiotelefoni TV.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kontratë pune e vlefshme;

b) Diplomë.

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.”.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, Seksioni B “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” dhe Seksioni D “Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera”, ndër të tjera, parashikohet se:

B. DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete

D: Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,
--

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

III.1.3. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e veçantë kualifikues, si më poshtë vijon:

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;”.

III.1.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.2 dhe pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të shtojcës 7 “FORMULARI I KRITEREVE TË të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ankimues “NIKA” SHPK në fazën e ofertimit ka paraqitur në në dokumentacionin e ofertës përkatësisht dokumentacionin si më poshtë:

- *Licensë NZ.2798/19, lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave Profesionale për Shoqëritë që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për shoqërinë “NIKA” SHPK, ku konstatohet se drejtues teknikë të shoqërisë janë personat e mëposhtëm:*

“Gentiana Mosko, Elsa Thano, Marita Tauzi, Arben Kruja, Myfid Ferhati, Jozaldo Sotir, Vladimir Prifti, Gabriela Pakuca, Xhevahir Llakaj, Arian Boshnjaku.”.

- *Shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të dokumenteve të tenderit, të plotësuar dhe dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “NIKA” SHPK ku në Seksionin B “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar si më poshtë vijon:*

Deklarata	Përgjigje
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:</i>	Punonjës

<i>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i>	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve 35 sa nr i kërkuar në DST për 3 muajt e fundit të deklaruar. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: I. Z/ZNJ. Gentiana Mosko me profesion Inxhinier Ndërtimi, drejtuese teknike dhe “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e Inxhinier Ndërtimi, drejtuese teknike dhe ‘Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	--

- Dokumenti i emërtuar “DEKLARATË” datë 27.05.2025, i përpiluar dhe vulosur nga administratori i shoqërisë ofertuese “NIKA” SHPK, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

DEKLARATË

Unë e nënshkruara Shpresa Nika, me cilësinë administratorit të operatorit ekonomik “NIKA” sh.p.k. deklaroj se në rast se do të jemi fitues në tenderin që do të zhvillohet në datë dt. 27/05/2025; nga Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara; me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, dhe me numër reference: REF-47417-05-09-2025, drejtues teknik i angazhuar për këtë tender do të jetë znj. Gentiana Mosko:

1. Drejtues teknik Gentiana Mosko:

E cila figuron e punësuar në shoqërinë “NIKA” Sh.p.k , dhe ka qënë e angazhuar në dy kontrata të tjera, por është zëveëndeësuar dhe njoftuar autoriteti kontrator (investitorit) konform neneve 2 e 4, Kreu I të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Ajo do të jetë e pranishëm/disponueshëm gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punimet për objektin e mësipërm.

(Bashkangjitur kësaj deklarata do të gjendet dhe shkresat përcjellëse për zvendësimin e drejtuesit teknik).

- Shkresa “Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri” nr. 20 prot, datë 21.02.2025, i përpiluar dhe vulosur nga administratori i shoqërisë ofertuese “NIKA” SHPK, drejtuar autoritetit kontraktor Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Nga ana e shoqërisë “Nika” shpk dhe Investitorit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është lidhur kontrata me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci” Shkodër” me numër reference: REF-31115-11-26-2024, me vlerë objekti: 167,518,221.60 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e një pikë gjashtë) leke me TVSH.

Në lidhje me këtë kontratë, drejtues teknik objekti (përgjegjës Teknik Kantieri) është caktuar Znj. Gentiana Mosko, por nga ana e shoqërisë “Nika” shpk, për shkaqe objektive kemi ndryshuar Drejtuesin Teknik, duke caktuar z. Adrian Kalamishi, Inxhinier Ndërtimi, i pajisur me licencën nr. Z 1207/5, datë 31.10.2006, si Përgjegjës Teknik Kantieri, i cili do të jetë rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Ky vendim i shoqërisë “Nika” shpk bazohet në nenet 2 e 4, Kreu I të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” në të cilët ndër të tjera parashikohet:

Neni 2: 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Neni 4: 4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dijeni lidhur me kontratën me objekt: Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci” Shkodër”, Përgjegjës Teknik i Kantierit do të jetë Z. Adrian Kalamishi, Inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë i pranishëm në objekt me kohë të plotë dhe do të ndjekë ecurinë e punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Bashkëngjitur kësaj shkrese fotokopje e diplomës dhe e licensës së z. Adrian Kalamishi”.

- Shkresa “Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri” nr. 19 prot, datë 21.02.2025, i përpiluar dhe vulosur nga administratori i shoqërisë ofertuese “NIKA” SHPK, drejtuar autoritetit kontraktor Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Nga ana e shoqërisë “Nika” shpk dhe Investitorit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është lidhur kontrata me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec” me numër reference: REF-30787-11-25-2024, me vlerë objekti: 52.933.902,2 (pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e tridhjet e tre mijë e nëntëqind e dy pikë tre) leke me TVSH.

Në lidhje me këtë kontratë, drejtues teknik objekti (përgjegjes Teknik Kantieri) është caktuar Znj. Gentiana Mosko, por nga ana e shoqërisë “Nika” shpk, për shkaqe objektive kemi ndryshuar Drejtuesin Teknik, duke caktuar z. Hektor KUSAKU, Inxhinier Ndërtimi, i pajisur me licencën nr. Z 1976/2, datë 04.07.2003, si Përgjegjës Teknik Kantieri, i cili do të jetë rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Ky vendim i shoqërisë “Nika” shpk bazohet në nenet 2 e 4, Kreu I të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” në të cilët ndër të tjera parashikohet:

Neni 2: 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Neni 4: 4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dijeni lidhur me kontratën me objekt: Rikonstrukcion i Shkollës së Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec”, Përgjegjës Teknik i Kantierit do të jetë Z. Adrian Kalamishi, Inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë i pranishëm në objekt me kohë të plotë dhe do të ndjekë ecurinë e punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Bashkëngjitur kësaj shkrese fotokopje e diplomës dhe e licensës së z. Hektor Kusaku)”.

III.1.5. Me shkresën nr. 1435/7 prot, datë 26.06.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me tonën me nr. 1568/3 prot, datë 27.06.2025, është depozituar informacioni i autoritetit kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt – shqyrtimi, së bashku me shkresën nr. 1435/6 prot, datë 25.06.2025 “Vendim KSHA 52/2025”, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“...

II.1. Lidhur me pretendimin e OE ankimes “NIKA” sh.p.k. shpk mbi arsyen e skualifikimit të ofertës së tij për disponimin e drejtuesit teknik të punimeve, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet Tenderit konkretisht në pikën 2.3.3 të “Kapacitetit Teknik” është përcaktuar se:

“2.3.3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kontratë pune e vlefshme;

b) Diplomë.

Në procesverbalin për “ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, datë 09.05.2025, lidhur me kriterin e sipërcituar është përcaktuar se:

”Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.”.

Në nenin 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë

atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

Në Kreun IV “DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË. DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës, me afat të përcaktuar (jo më pak se 1 (një) vit).

2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike.

Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për kërkesë, si dhe dorëzimin e kopjes origjinale të këtyre licencave pranë arkivit së sektorit përgjegjës për licencimin, përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën.

Licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, i kthehet personit sapo ai shkëput marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë.”.

Në UDHËZIM Nr.2, datë 13.5.2005 “PËR ZBATIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, KREU I “SIPËRMARRRESI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, pika 2 përcaktohet:

“2. Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër,

publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.”.

Gjithashtu, në Shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, Pjesa III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika D, përcaktohet se:

“Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Të Tjera”.

KSHA gjykon se kërkesa për kualifikim (2.3.3.) është argumentuar qartë nga ana e autoritetit kontraktor referuar procesverbalit për “Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim”, duke e vlerësuar si një kërkesë të saktë e të mbështetur pasi, referuar pikës 1 të Kreut IV të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, një nga dokumentet e nevojshme që duhet të paraqesin aplikantët pranë komisionit të licencave për t’u bërë drejtues teknikë është dhe dokumentacioni teknik justifikues për veprimtarinë e kryer nga kandidati, i cili është personi që drejton punimet në kantier dhe merret me zbatimin me korrektësi të preventivit të punimeve sipas zërave të përcaktuar në të.

Pra kjo kërkesë e autoritetit kontraktor është në përpjesëtim me volumin dhe objektin e kontratës, pasi vetë ofertuesi nëse shpallet fitues duhet të caktojë një person i cili është përgjegjës për kryerjen e punimeve, zbatimin e projektit dhe specifikimeve teknike dhe që mban kontaktet me përfaqësuesin e autoritetit kontraktor, supervizorin e punimeve dhe kolaudatorin e punimeve për kryerjen me korrektesë të punimeve objekt prokurimi.

Akoma më tej, kjo kërkesë lidhet ngushtë edhe me pikën 2,1 të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”, KREU I “Sipërmarrësi i Punimeve të Ndërlimit”, ku përcaktohet qartë se për vepra me vlerë mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi, kjo gjithashtu, referuar edhe gjurmës a) të Kreut IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, ku parashikohet shprehimisht se: “Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5)”.

KSHA thekson se detyrimi që drejtuesi teknik i punimeve të jetë i paangazhuar në kontrata të tjera gjatë kohëzgatjes së kontratës objekt prokurimi, është plotësisht i justifikuar dhe synon garantimin e cilësisë dhe të sigurisë në realizimin e punimeve. Drejtuesi teknik ka një rol thelbësor në monitorimin, koordinimin dhe drejtimin e veprimtarisë teknike në kantier. Angazhimi i tij është i domosdoshëm për sigurimin e mbikqyrjes së vazhdueshme në kantier çka ndikon në parandalimin e vonesave dhe gabimeve teknike që mund të kenë pasoja ligjore dhe ekonomike. Përkundër konfuzionit të krijuar në deklaratimet e bëra nga ankimesi si pjesë e procesit të ofertimit dhe gjithashtu përkundër pretendimit të paraqitur në ankesë, se një drejtues teknik mund të jetë i angazhuar në disa kontrata njëkohësisht, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se ky fakt është në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, si dhe nuk do të mundësonte përmbushjen me korrektësi të detyrimeve kontraktuale. Një drejtues teknik i cili është i angazhuar në disa kontrata nuk mund të garantojë të njëjtin nivel përfshirjeje dhe përgjegjshmërie ndaj objektit të kontratës.

KSHA e konsideron të drejtë vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që referuar legjislacionit në fuqi, nuk mund të ndryshohet drejtuesi teknik i deklaruar në dokumentet e tenderit, detyrim ky i nevojshëm për të garantuar vazhdimësinë teknike, cilësinë e punimeve dhe përgjegjshmërinë e zbatimit të kontratës. Drejtuesi teknik është përgjegjës për organizimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen teknike të punimeve, zotëron njohuri të detajuara mbi projektin teknik që në fazën e ofertimit dhe hartimit të planit të punës, ndaj zëvendësimi i tij gjatë zbatimit të kontratës ndikon negativisht në vijimësinë e punimeve, duke ndikuar

gjithashtu drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe afatet e përfundimit të kontratës. Lejimi i zëvendësimit të drejtuesit teknik, përveç rasteve të jashtëzakonshme dhe me arsye madhore, pas nënshkrimit të kontratës, do të cënonte gjithashtu parimin e barazisë dhe konkurrencës, të konsideruar dhe vlerësuar në fazën e ofertimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson, se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika l e ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin parashikohet se: "1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë."

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarim pranë OPB-së parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se: "1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. [...]"

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "NIKA" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës."

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. A

ftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.8. Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. 6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”.

III.1.9. Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.10. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.1.11. Në Kreun IV “*DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “*Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*”, i ndryshuar, parashikon se:

KREU IV

DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës, me afat të përcaktuar (jo më pak se 1 (një) vit).

2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike.

Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për kërkesë, si dhe dorëzimin e kopjes origjinale të këtyre licencave pranë arkivit së sektorit përgjegjës për licencimin, përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën.

Licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, i kthehet personit sapo ai shkëput marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë.

III.1.12. Në Kreun I “*SIPËRMARRËSI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT*” pika 2 dhe pika 4 të Udhëzimit të Kryeministrit Nr.2, datë 13.5.2005 “*Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, përcaktohet se:

“2. Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër,

publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi

teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

2.2 Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.

...

4. Për zbatimin e punimeve të ndërtim-montimit, në sheshin e liruar të ndërtimit ngrihet, përkohësisht, kantieri i punimeve, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në projektorganizim.

4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.”.

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.14. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3. “*Kapciteti teknik*” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” në shtojcën 7 “*Formulari i Kriterëve*

të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomik ofertues duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate personin që do të jetë Përgjegjës i Kantierit (në rast se operatori ekonomik ofertues do të shpallet fitues i procedurës së prokurimit), ku ky person duhet të jetë në rolin e Drejtuesit Teknik të shoqërisë ofertuese, si dhe njëkohësisht të jetë i punësuar pranë shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit nga data e dorëzimit të ofertës.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky kriter kualifikues në fazën e ofertimit do të konsiderohet i plotësuar nëpërmjet deklarimit të personit, i cili do të jetë Përgjegjës Kantieri në Seksionin B “*DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”*” të Shtojcës 8 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të dokumenteve të tenderit dhe dorëzimit të kësaj shtojce si pjesë përbërëse e dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik ofertues, ndërkohë që në rast se ky ofertues do të kualifikohet i pari atëherë ka detyrimin që sipas përcaktimeve të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, duhet të dorëzojë kontratën e punës dhe diplomën e vlefshme, sipas deklarimeve të bëra në Shtojcën 8 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të dorëzuar, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.15. Lidhur me arsyen e mësipërme të skualifikimit të dhëna nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, sipas pikës III.1. të këtij vendimi, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ankimuesi “NIKA” SHPK konstaton se ky operator ekonomik ofertues në Seksionin B “*DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”*” të Shtojcës 8 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të dorëzuar ka deklaruar se znj. Gentiana Mosko e diplomuar “*Inxhinierë Ndërtimi*” është e punësuar pranë kësaj shoqërie në rolin e Drejtuesit Teknik të shoqërisë, deklarim i cili është i saktë referuar

Licensës NZ.2798/19, lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave Profesionale për Shoqëritë që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për shoqërinë “NIKA” SHPK.

Gjithashtu ky operator ekonomik ofertues ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës dokumentin e emërtuar “*DEKLARATË*” të datës 27.05.2025, ku deklaron se znj. Gentiana Mosko do të jetë e pranishëm/disponueshme gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punimet, në rast se shpallet fitues i procedurës së mësipërme të prokurimit.

Për më tepër, operatori ekonomik ofertues “NIKA” SHPK, me shkresën “*Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri*” nr. 20 prot, datë 21.02.2025 dhe me shkresën “*Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri*” nr. 19 prot, datë 21.02.2025, ka njoftuar kontraktorin Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit se për kontratën me objekt: “*Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci” Shkodër*” ka zëvendësuar Përgjegjësin Teknik të kantierit znj. Gentiana Mosko dhe inxhinierin e ndërtimit z. Adrian Kalamishi, i cili do të jetë Përgjegjës Teknik i kantierit për këtë kontratë, ndërsa për kontratën me objekt: “*Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec*” ka

zëvendësuar Përgjegjësin Teknik të kantierit znj. Gentiana Mosko dhe inxhinierin e ndërtimit z. Hektor Kusaku, i cili do të jetë Përgjegjës Teknik i kantierit për këtë kontratë.

Referuar këtij dokumentacioni, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues “NIKA” SHPK në fazën e ofertimit është në kushtet e plotësimit të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3. “*Kapciteti teknik*” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” në shtojcën 7 “*Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi nëpërmjet Shtojcës 8 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” dhe dokumentit të emërtuar “*DEKLARATË*” të datës 27.05.2025, ka deklaruar se znj. Gentiana Mosko, me cilësinë e drejtuesit teknik të shoqërisë do të jetë do të jetë e pranishëm/disponueshme gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punimet, sipas përcaktimeve të Kreut I “*SIPËRMARRËSI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT*” pika 2 të Udhëzimi të Kryeministrit Nr.2, datë 13.5.2005 “*Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, nisur nga fakti që procedura e prokurimit objekt ankimi për të cilën është bërë kjo deklaratë është mbi vlerën 30 000 000 (*tridhjetë milionë*) lekë, ndërkohë që me shkresën “*Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri*” nr. 20 prot, datë 21.02.2025 dhe me shkresën “*Njoftim për caktim Përgjegjës Teknik Kantieri*” nr. 19 prot, datë 21.02.2025 i ka vërtetuar autoritetit kontraktor se znj. Gentiana Mosko nuk është me e angazhuar në kontrata të tjera në rolin e Përgjegjës Teknik të kantierit dhe konkretisht në kontratën me objekt: “*Rikonstruktion i Shkollës së Mesme Profesionale “Arben Broci” Shkodër*” dhe në kontratën me objekt: “*Rikonstruktion i Shkollës së Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec*”, duke njoftuar kontraktorin e të dyja kontratave dhe konkretisht Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, se ka zëvendësuar znj. Gentiana Mosko përkatësisht me inxhinierin e ndërtimit z. Adrian Kalamishi dhe inxhinierin e ndërtimit z. Hektor Kusaku, sipas përcaktimve të Kreut I “*SIPËRMARRËSI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT*” pika 4 të Udhëzimi të Kryeministrit Nr.2, datë 13.5.2005 “*Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar.

Përsa më sipër, KPP gjykon në fazën e ofertimit operatori ekonomik ankimues “NIKA” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar përmbush kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3. “*Kapciteti teknik*” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” në shtojcën 7 “*Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ofertues “NIKA” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-47417-05-09-2025, me objekt: “Rikonstruksioni i objektit nr.2, “godinë 3-katëshe”, në Repartin Ushtarak Nr.1010 Vau-Dejës, Shkodër”, me fond limit 35.605.664,51 leke pa TVSH zhvilluar me datë 27.05.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “NIKA” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në djeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

0

